

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8276  
E mërkurë, 8 prill 2026  
Çmimi 0.50 €

## Trumpi kërcënon Iranin me shkatërrim total



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KRIZA PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT VAZHDON, PARTITË PA MARRËVESHJE POLITIKE



Partitë politike kanë nisur takimet për arritjen e një marrëveshje konsensuale për presidentin e ri, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e

parakohshme, ndërsa afati kushtetues po afrohet dhe presioni për një zgjidhje po rritet çdo ditë. Njohës të proceseve politike kanë theksuar se vetëm një gjuhë

e përbashkët politike sjell një president të unitetit dhe funksionalitet normal të shtetit, ndryshe vendi do të përballet edhe me një krizë të re politike

## AKTUALE



LDK-ja DORËZON DOSJEN NË POLICI PËR NJEHSORËT ELEKTRIKË F. 3

RAMA THOTË SE DO TË RIKTHEHET TELEFERIKU I GËRMISË F. 6

EDHE PESË SHTËPI TË TJERA PËR FAMILJET ME KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE NË PODUJEVË F. 3

## EKONOMI



NAFTA TË MARTËN NË KOSOVË 1.88 EURO PËR LITËR, BENZINA 1.46 EURO F. 8

AZEMI: PUNËTORËT TEKNIKË DHE FIZIKË TË PRISHTINËS KËRKOJNË PAGË PREJ 600 EUROSH F. 8

## SPORT



KOMISIONI PARLAMENTAR MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR LOJËRAT MESHETARE "PRISHTINA 2030" F. 11



'SHTET NJËPARTIAK', ISA MUSTAFA PARALAJMËRON KRIZË NËSE PUSHTETI MERR EDHE PRESIDENTIN F. 3



PËRBALLË SHITJESË TË NAFTËS, A JANË VETURAT ELEKTRIKE OPSION PËR QYTETARËT? F. 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbr: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# TRUMPI KËRCËNON IRANIN ME SHKATËRRIM TOTAL



Uashington, 7 prill - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, përsëriti kërcënimin e tij për t'i shkatërruar termocentralet dhe urat e Iranit, nëse ky i fundit nuk bën marrëveshje për t'i dhënë fund luftës dhe për ta hapur Ngushticën e Hormuzit. Trumpi paralajmëroi se Irani mund të "shkatërrohet brenda një nate".

Duke folur në një konferencë për medie në Shtëpinë e Bardhë, së bashku me sekretarin e Mbrojtjes, Pete Hegseth, kryetarin e Shtabit të Përgjithshëm, Dan Caine, dhe drejtorin e CIA-s, John Ratcliffe, Trumpi e përshkroi momentin si një pikë vendimtare në një konflikt që po përshkallëzohet shpejt. "I gjithë vendi mund të shkatërrohet brenda një nate dhe ajo natë mund të jetë nesër", tha Trumpi, duke kujtuar afatin e 7 prillit që i ka vënë Iranit për t'i përmbushur kërkesat e ShBA-së. "Kjo është një periudhë kritike. Ata kanë kohë deri nesër në orën tetë", tha Trumpi.

Teherani dha pak shenja të zmbarsjes. Më herët gjatë ditës, zyrtarët iranianë hodhën poshtë një propozim armëpushimi prej 15 pikash nga Uashingtoni, ndërsa luftimet me Izraelin i shtuan gjatë natës.

Trumpi tha se nuk mund ta diskutonte propozimin, por theksoi se Uashingtoni ka "një pjesëmarrës aktiv dhe të gatshëm në anën tjetër" të negociatave. I pyetur nëse është i shqetësuar se bombardimi i termocentraleve

dhe urave do të shihej si krim lufte, Trumpi tha: "Jo. Shpresoj të mos më duhet ta bëj".

E ashtuquajtura Komandë e Përbashkët Ushtarake e Iranit - organi që koordinon operacionet midis Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) dhe ushtrisë së rregullt - i përshkroi komentet e presidentit amerikan si "retorikë e vrazhdë dhe arrogante", raportoi mediumi "Nour News", duke cituar një deklaratë të kësaj komande.

Konferenca e Trumpit nisi me atë që ai e përshkroi si një mision "shumë historik" shpëtimi: nxjerrjen e dy ushtarakëve amerikanë, aeroplani luftarak F-15 i të cilëve u rrëzua mbi territorin e Iranit. Sipas Trumpit dhe udhëheqjes së tij ushtarake, operacioni përfshiu një angazhim masiv me mbi 150 avionë - përfshirë bombardues, avionë luftarakë, cisterna për furnizim me karburante dhe njësi shpëtimi - që vepruan nën zjarrin e madh të armikut. "Nuk lëmë asnjë amerikan pas. Mund të kishim përfunduar me 100 të vdekur", tha ai.

Një nga pilotët e rrëzuar, i plagosur rëndë, mbijetoi gati 48 orë pas vijave të armikut, duke e shmangur kapjen në terrenin e kontrolluar nga Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike të Iranit. Trumpi tregoi se si piloti "u ngjiti në shkëmbin, mjaft i gjakosur", ndërsa trajtonte vetë plagët e tij, njëkohësisht transmetonte vendndodhjen.

Gjenerali Caine tregoi se

operacioni i shpëtimit ishte mbuluar nga një "armadë ajrore", ndërsa Ratcliffe shtoi se misioni bëri një "fushatë mashtruese" për t'i ngatërruar forcat iraniane që po e ndiqnin pilotin.

"Ishte garë kundër kohës", tha Ratcliffe, duke vënë në dukje përdorimin si të inteligjencës njerëzore, po ashtu edhe të teknologjive të përparuara të mbikëqyrjes.

Analistët ushtarakë thonë se operacioni veçohet për kompleksitetin e tij.

Duke folur për Radion Evropa e Lirë, gjeneraljejtënantin në pensionin i Forcave Ajrore të ShBA-së, David A. Deptula, e përshkruan atë si një shpëtim të rrallë luftarak dhe shumë dinamik. "Kjo përfshiu një operacion të rimëkëmbjes në thellësi brenda territorit armiqësor iranian, vendndodhjen e pasigurt të mbijetuarit, ndjekjen nga armiku, terrenin malor dhe adaptimin në kohë reale me sulmet", thotë ai. Sipas tij, misionet e tilla kërkojnë koordinim midis inteligjencës, fuqisë ajrore dhe komunikimeve, ndërsa sinjalizojnë si aftësinë e ShBA-së, ashtu edhe rreziqet e vazhdueshme të operimit mbi Iran.

Gjatë konferencës në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi zbuloi se jo të gjithë zyrtarët ushtarakë e mbështetën misionin e shpëtimit - disa shprehën shqetësime për rrezikun e dërgimit të qindra ushtarëve në territorin iranian, i cili vazhdon të jetë shumë i

mbrojtur. "Zakonisht nuk bëhet... Qindra njerëz mund të ishin vrarë", tha Trump.

Pavarësisht prej këtyre kundërshtimeve, ai tha se personalisht e miratoi operacionin, duke e përshkruar rezultatin - pa viktime - si "pothuajse të pamundur".

## Ultimatumi dhe përshkallëzimi

Paralajmërimi i Trumpit fokusohet te kontrolli i Iranit mbi Ngushticën e Hormuzit - një pikë kyç për dërgesat globale të naftës. Sipas tij, edhe ndërprerjet e kufizuara të lundrimit - si me anë të vendosjes së minave detare - mund ta paralizojnë transportin ndërkombëtar detar.

Ndërsa tha se forcat amerikane kanë neutralizuar në masë të madhe forcat detare dhe ajrore të Iranit, Trumpi pranoi se kërcënime ka. "Mjafton vetëm një terrorist me një kamion dhe një minierë uji", tha Trumpi, duke vënë në dukje cenueshmërinë e trafikut detar.

Pavarësisht prej retorikës së ashpër, Trumpi shtoi se negociatat janë duke vazhduar "me mirëbesim". "Ata do të donin të bënin marrëveshje", tha ai, por nuk dha hollësi.

Duke iu referuar komunikimeve të përgjuara, Trumpi përsëriti se shumë iranianë i mbështesin sulmet e ShBA-së si "një rrugë drejt lirisë". "Ata po thonë, 'Ju lutem, vazhdojini bombardimet'", tha Trumpi, duke shtuar se civilët

janë të gatshëm t'i përballojnë vështirësitë për ta rrëzuar regjimin.

Në të njëjtën kohë, ai pranoi edhe rreziqet me të cilat përballen protestuesit iranianë, duke kujtuar goditjet e forcave të sigurisë kundër tyre. "Unë, në fakt, u them atyre të mos dalin. Nuk është çështje trimërie - është inteligjencë", tha Trumpi, duke përmendur ekzekutimet dhe shtypjen - përfshirë vrasjen e protestuesve dhe disidentëve - për ta justifikuar qëndrimin e tij të ashpër kundër Teheranit.

Trumpi shfrytëzoi konferencën edhe për të kërcënuar një gazetar që raportoi detaje për pilotin e bllokuar para se misioni i shpëtimit të përfundonte. "Do t'i themi: 'Siguria kombëtare - dorëzohuni ose shkoni në burg'", tha Trumpi, duke iu referuar burimit të rrjedhjes së informacionit. Ai argumentoi se publikimi i informacionit mund të kishte paralajmëruar forcat iraniane dhe të kishte komplikuar operacionin, por nuk e përmendi emrin e medias së përfshirë.

Këto zhvillime vijnë në kohën kur konflikti vazhdon të përshkallëzohet në të gjithë rajonin.

Izraeli njoftoi se ka goditur objektiva kyçe iraniane gjatë natës, përfshirë infrastrukturën energjetike, ndërsa Irani, në përgjigje, nisi sulme të reja. Mediet shtetërore iraniane raportuan më 6 prill se të paktën 19 persona humbën jetën dhe 20 u plagosën nga sulmet ajrore amerikane dhe izraelite pranë Teheranit.

## Më shumë vizitorë në hotele në shkurt 2026 sesa një vit më parë

PRISHTINË, 7 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e hotelierisë për muajin shkurt 2026. Në shkurt 2026 numri i vizitorëve në hotele ishte 56 644, prej tyre vizitorë vendorë

ishin 24 416 dhe vizitorë të jashtëm ishin 32 228. Krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025 (sa ishin 51 795 vizitorë), pati rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 9,4 %.

Numri i net-qëndrimeve ishte 112 367, prej tyre 60 513 (53,8 %) nga vizitorët e jashtëm dhe 51 854 (ose 46,1 %) nga vendorët e brendshëm. Sa i përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën

paraprake (shkurt 2025) pati një rritje të vizitorëve për 16,1 %. Në total 32 228 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishte nga: Shqipëria, Gjermania, Turqia, Zvicra etj.



## LDK-JA DORËZON DOSJEN NË POLICI PËR NJEHSORËT ELEKTRIKË

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 PRILL - Sekretari Organizativ i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Visar Azemi, ka dorëzuar në Departamentin e Hetimeve një dosje që lidhet me funksionimin e njehsorëve elektrikë në vend. Sipas tij, dokumentacioni përfshin prova që, sipas LDK-së, tregojnë parregullsi në matjen dhe faturimin e energjisë elektrike. "Sot në Policinë e Kosovës kam dorëzuar dëshmi të mbledhura

të qytetarëve të Kosovës lidhur me skandalin e njehsorëve elektrikë. Për këtë skandal kërkova hetim të pavarur nga Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykata. Ky skandal, i cili po mundohet të minimizohet nga KEDS dhe Ministria e Industrisë, duhet të marrë fund dhe paratë e vjedhura të kthehen te qytetarët. Prandaj, për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe për t'i kërkuar paratë e vjedhura, këtë javë do të filloj organizimin e një peticioni në të gjithë Kosovën. Qytetarët meritojnë

kompensim, llogaridhënie dhe transparencë!", ka thënë ai pas dorëzimit të dëshmi në Policinë e Kosovës lidhur me skandalin e njehsorëve elektrikë. E njëjta çështje është adresuar edhe në Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe në kompaninë KEDS. Nga kjo parti pretendohet se, nga gjithsej 884 njehsorë të verifikuar, rreth 87 për qind e tyre kanë rezultuar me matje që çojnë në fatura më të larta për qytetarët, edhe në rastet kur aplikohet tarifa më e ulët.



## KPK DHE KGJK BASHKËRENDONJË QËNDRIMET PËR PROJEKTLIGJET NË FUSHËN E DREJTËSISË



PRISHTINË, 7 PRILL - Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, kryetari i Komisionit për Çështje Normative të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Visar Krasniqi, së bashku me anëtarin e këtij komisioni, Bahri Hyseni, si dhe sekretaren e komisionit, Margarita Gjocaj, kanë zhvilluar të martën një takim pune me përfaqësuesit e grupit punues nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Bisnik

Bislimaj, Ngadhnjim Armi dhe Argzon Muçaj. Takimi u fokusua në shkëmbimin e pikëpamjeve dhe koordinimin e qëndrimeve institucionale lidhur me projektligjet e hartuara nga Ministria e Drejtësisë të cilat rrjedhin nga Deklarata e Përbashkët e Zotimit. Në këtë drejtim, pjesëmarrësit diskutuan çështje me rëndësi për avancimin e kornizës ligjore, duke theksuar

nevojën për harmonizim të qëndrimeve në fushat e përbashkëta dhe për një qasje të koordinuar ndërinstytucionale. Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sistemit të drejtësisë, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të reformave dhe sigurimit të një kornize ligjore sa më të qëndrueshme dhe efektive.

## EDHE PESË SHTËPI TË TJERA PËR FAMILJET ME KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE NË PODUJEVË

PODUJEVË, 7 PRILL - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka bërë me dije se me hoxhën Halil Kastrati kanë nënshkruar marrëveshje për ndërtimin edhe të pesë shtëpive të tjera për familjet me kushte të rënda ekonomike në komunën e Podujevës. "Bazuar në këtë marrëveshje, Komuna participon me nga 10 mijë euro për secilën shtëpi (50 mijë në total), kurse pjesën tjetër të shpenzimeve e mbulon Shoqata 'Jetimat e Ballkanit'. Bashkë me humanistin Kastrati, sot i kemi vizituar edhe 2 familje përfituese të shtëpive, që ndërtohen bazuar në marrëveshjen e kaluar, po ashtu për 5 shtëpi. Edhe në këtë



marrëveshje, Komuna participon me nga 10 mijë euro për secilën shtëpi. E falënderova hoxhën e nderuar Halil Kastrati për këtë bashkëpunim të shkëlqyer që kemi për realizimin e projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve tanë!", ka thënë Bulliqi.

## Haxhiu pret Avokatin e Popullit të Shqipërisë, në fokus tema e të drejtave të qytetarëve

PRISHTINË, 7 PRILL - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim Avokatin e Popullit të Republikës së Shqipërisë, Endri Shabani, i shoqëruar nga një delegacion, si dhe Avokatin e Popullit të Republikës së Kosovës, Naim

Qelaj. Gjatë takimit u diskutua për rolin dhe rëndësinë e institucioneve të Avokatit të Popullit në të dyja republikat, me theks të veçantë në punën dhe angazhimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve. Po ashtu, bashkëbisedimi u

fokusua edhe në praktikën më të mira të raportimit të këtyre institucioneve në kuvendet përkatëse, duke u theksuar rëndësia e bashkëpunimit dhe komunikimit të ndërsjellë si dhe mundësitë për forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëveprimi.





# KRIZA PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT VAZHDON, PARTITË PA MARRËVESHJE POLITIKE

Partitë politike kanë nisur takimet për arritjen e një marrëveshje konsensuale për presidentin e ri, në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e parakohshme, ndërsa afati kushtetues po afrohet dhe presioni për një zgjidhje po rritet çdo ditë. Njohës të proceseve politike kanë theksuar se vetëm një gjuhë e përbashkët politike sjell një president të unitetit dhe funksionalitet normal të shtetit, ndryshe vendi do të përballlet edhe me një krizë të re politike

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 7 PRILL** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, janë takuar të hënë në lidhje me çështjen e zgjedhjes së presidentit të vendit në mënyrë që të shmangen zgjedhjet e reja.

As ky takim nuk prodhoi marrëveshje politike. Kryeministri Kurti, i cili është edhe lider i LV-së, ka thënë se janë të përcaktuar që t'i shmangin zgjedhjet e reja. "Jemi të përcaktuar që t'i shmangim zgjedhjet e reja, sepse ato nuk do

të ishin zgjidhje për numrin prej 80 deputetësh. Me fjalë të tjera, është e vështirë që të paramendohet një fushatë zgjedhore ku ne i risjellim platformat dhe programet tona dhe me po të njëjtat zotime kërkojmë sërish votën e të njëjtëve qytetarë për një rezultat që e dimë që nuk mund të jetë shumë ndryshe", ka thënë Kurti pas takimit pothuajse dyorësh që ka zhvilluar me kreun e LDK-së në ambientet e Kuvendit. Ai ka thënë se disa pika të takimit do të mbesin konfidenciale, pa treguar se në çfarë drejtimi është diskutuar për pozitën e presidentit. Takimi është zhvilluar pas

përfundimit të mandatit presidencial të Vjosa Osmanit më 4 prill.

Të njëjtën ditë pozitën e ushtrueses së detyrës e ka marrë Albulena Haxhiu, kryetare e Kuvendit, ashtu siç parashihet me Kushtetutë. "Ndodhemi aty ku ndodhemi. Unë vazhdoj të jem optimist se me takime dhe bisedime të këtilla do të mund të arrijmë një marrëveshje politike, por këtë nuk mund të them që e kemi sot, veçse atmosfera konstruktive në njërin anë dhe dashamirësia që t'i shmangim zgjedhjet e reja që nuk janë zgjidhje, në anën tjetër, më bën optimist për këto tri javët e mbetura që uroj të mos i shfrytëzojmë deri në ditën apo orën e fundit", ka deklaruar Kurti, duke paralajmëruar takime edhe me Bedri Hamzën, kreun e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), partisë më të madhe opozitare në vend. Sipas një komunikate të cituar nga mediet lokale në Kosovë, Hamza i ka kthyer përgjigje Kurtit lidhur me ftesën për takim, duke i kërkuar ta konkretizojë iniciativën e tij të re

përmes një letre zyrtare, në mënyrë që për këtë temë të diskutohet në organet e partisë dhe më pas të paraqitet qëndrimi përfundimtar i PDK-së.

E Abdixhiku ka thënë pas takimit se palët po përpiqen të arrijnë deri te një zgjidhje. "Po provojmë të gjejmë zgjidhje të përbashkët, konsensuale, me takime. Kjo është rruga që duhet ndjekur përpara. Do ta ndjekim këtë rrugë sa herë që mundemi për t'i shmangur zgjedhjet". I pyetur nëse LDK-ja pati emra konkretë për pozitën e presidentit, ai tha se palët "nuk kanë arritur ende në atë fazë". "Në proces janë dy emra, kandidatë të Lëvizjes Vetëvendosje dhe LDK-ja e ka pozicionin e vet të qartë se jo të gjitha pozitat shtetërore mund t'i takojnë një partie politike, ky është pozicioni ynë".

Ushtruesja e presidentit, Albulena Haxhiu, është shprehur e hapur të martën që të ndihmojë "nëse mundet" në çështjen e zgjedhjes së presidentit të ri të vendit. "Tashmë takimet po vazhdojnë.

Ka pasur edhe dje takim, do të ketë edhe ditëve në vijim. Unë jam shumë e hapur për të ndihmuar nëse mundem në këtë drejtim", ka deklaruar Haxhiu pas një takimi që pati me avokatin e Popullit të Shqipërisë. Njohës të proceseve politike në vend kanë bërë thirrje që partitë politike të jenë të unifikuara në zgjedhjen e presidentit të vendit. Ish-zëvendëskryeministrja Edita Tahiri ka thënë se vetëm një gjuhë e përbashkët politike sjell një president të unitetit dhe funksionalitet të shtetit, dhe jo si në mandatin e kaluar, duke iu referuar zgjedhjes së ish-presidentes Vjosa Osmani. Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë se zgjedhja e presidentit do të ishte lajm i mirë, duke potencuar se nuk duhet të ndalen takimet deri në arritjen e një marrëveshje politike. "Një marrëveshje për presidentin e ri do të shënonte veprim të pjekur politik nga partitë parlamentare dhe lidhshipi i tyre. Jam i bindur se kjo do t'i mundësonte Kosovës kornizë të stabilitetit dhe, rrjedhimisht, qartësi të

# “SHTET NJËPARTIAK”, ISA MUSTAFA PARALAJMËRON KRIZË NËSE PUSHTETI MERR EDHE PRESIDENTIN

PRISHTINË, 7 PRILL - Të hënën janë riaktivizuar diskutimet politike lidhur me zgjedhjen e presidentit të vendit, në një kohë kur ende mungon një konsensus ndërmjet pozitës dhe opozitës.

Lidhur me këtë çështje ish-kryetari i LDK-së, ish-kryeministri Isa Mustafa, fillimisht ka sqaruar se cilat opsione nuk i konsideron si zgjidhje të pranueshme për situatën aktuale. “Së pari po shprehem se çfarë nuk është zgjidhje. Zgjidhje nuk do të ishte që LV-ja, duke e pasur shumicën në kuvend, kryeparlamentarin dhe qeverinë, ta ketë edhe presidentin. Kështu do të ktheheshim në një shtet njëpartiak”, ka thënë ai në një bisedë për “IndeksOnline”.

Ai paralajmëron për rrezikun e përqendrimit të pushtetit në një subjekt të vetëm politik, duke e parë këtë si cenim të balancës demokratike.

Mustafa thekson se zgjidhja duhet të vijë përmes bashkëpunimit ndërmjet pozitës dhe opozitës, duke përfshirë edhe mundësinë e një

kandidature jashtë shumicës: “Do të ishte zgjidhje që partia që ka shumicën të tregojë vullnet për një president nga opozita ose për një personalitet për të cilin pajtohen pozita dhe opozita”, vlerësoi ai. Sipas tij, një qasje e tillë do të ndihmonte në ruajtjen e balancave institucionale dhe politike në vend. Duke folur për karakteristikat që duhet të ketë një kandidat i mundshëm, Mustafa pranon vështirësinë e arritjes së një figure ideale, por nënvizon disa parime bazë. “Këtë figurë është vështirë ta gdhendim si skulptor, por të pajtohem se nuk ka të përkryer. Të jetë një njeri që siguron balancë të brendshme, mbrojtje të kushtetutës dhe përfaqësim jashtë në interes të vendit”, tha Mustafa në një prononcim për “IndeksOnline”. Në mungesë të vullnetit politik për kompromis, Mustafa sugjeron që vendi mund të përballet me zgjedhje të reja. “Nëse nuk gjendet ky vullnet, do të ishte më mirë të përfundohet ky cikël i amullisë dhe të shkohet në zgjedhje”.

Në fund ai e vendos situatën



politike edhe në një kontekst më të gjerë global, duke theksuar mungesën e orientimit strategjik. “Ndryshimet gjeopolitike dhe ato gjeoekonomike kërkojnë nga çdo vend t’i definojë interesat e veta.

Duket se ne nuk jemi në këtë rrugë!”

Me aktgjykimin e shpallur nga Kushtetuesja, më 25 mars u përcaktua afati prej 34-ditësh për zgjedhjen e presidentit,

konkretisht deri më 28 prill. Nëse presidenti nuk arrin të zgjidhet brenda këtij afati, vendi shkon automatikisht në zgjedhje të parakohshme që duhet të mbahen brenda 45-ditësh.

## AVANCIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE NË FOKUS TË TAKIMIT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE NORMATIVE



PRISHTINË, 7 PRILL - Komisioni për Çështje Normative (KÇN) ka mbajtur takimin e radhës, të udhëhequr nga kryetari i Komisionit, Visar Krasniqi, me pjesëmarrjen e anëtarëve Bahri Hyseni, Veton Shabani si dhe Margarita Gjocaj, sekretare e Komisionit.

Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilët kontribuan me rekomandime konkrete lidhur me çështjet në shqyrtim.

Gjatë takimit Komisioni diskutoi analizën e Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit të

Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive, dhe pas saj Draftin e Rregullores për plotësim dhe ndryshim të së njëjtës duke vendosur që kjo rregullore të procedohet për dëgjim publik.

Po ashtu, u shqyrtuan komentet e sistemit prokurorial lidhur me projektligjet që rrjedhin nga Deklarata e Përbashkët e Zotimit. Në vijim, Komisioni trajtoi dhe miratoi Draft Rregulloren për procedurën disiplinore të anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), me theks të veçantë në forcimin e llogaridhënies dhe rritjen e transparencës institucionale. Gjithashtu, të njëjtët vendosën

që këtë Draft Rregullore ta procedojnë për trajtim të mëtutjeshëm në KPK.

Në kuadër të zhvillimeve strategjike u diskutuan edhe aktivitetet e grupeve punuese për hartimin e Planit Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi, si dhe përgatitja e analizës dhe Draft Rregullores për komunikim me publikun.

Komisioni për Çështje Normative do ta vazhdojë angazhimin në avancimin e kornizës rregullative dhe në forcimin e funksionimit të sistemit prokurorial në përputhje me standardet më të larta profesionale.

viteve përpara. Mos i ndalni takimet deri kur të arrihet marrëveshja. Pasi ato kanë rifilluar, e mendoj të rëndësishme që të përmbillen me rezultat. E kundërta do të shënonte papjekuri!”, ka thënë Ramadani.

Deputeti i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se muaji prill është muaji që do të determinojë nëse ka vullnet politik në Kosovë për zgjedhjen e presidentit të ri. “Nëse ka marrëveshje për bashkëpunim, pa të cilën nuk

del rezultati, sepse pragmatizmi dhe kompromisi janë vlera politike e jo dobësi. Sa më shumë fiton mbështetje, bëhesh më i përgjegjshëm, sepse duhet ndarë me të tjerët. Në të kundërtën, Kosova, për mungesë pragmatizmi, duhet të zgjedhë përmes gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese ose zgjedhjeve 8-milionëshe. Ky popull i Kosovës është evropian me orientim, nuk meriton qeverisje tjetër pos asaj euroatlantike, ku LDK tash e 37

vjet beson, punon e ndërton!”, ka shkruar Haziri në “Facebook”. Më 5 mars, Lëvizja Vetëvendosje (LV) e Kurtit, parti në pushtet, i ka propozuar dy emra për pozitën e presidentit: Glauk Konjufcën, ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe deputeten Fatmire Mullhaxha-Kollçaku. Në mungesë kuoromi, procesi ka mbetur në gjysmë. Të nesërmen ish-presidentja Osmani e ka paraqitur një deket për shpërndarje të Kuvendit dhe hapje të rrugës për zgjedhje të

reja. Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo nuk e siguroi mbështetjen e nevojshme në këtë drejtim.

LV-ja e çoi dekretin e Osmanit në Gjykatën Kushtetuese, duke e konsideruar jokushtetues. Gjykata më pas doli me vendim duke thënë se dekreti i ish-presidentes nuk ka pasur asnjë efekt juridik dhe e përcaktoi 28 prillin si afat të fundit për zgjedhje të presidentit, në të kundërtën shteti shkon në zgjedhje që duhen të mbahen

brenda 45 ditësh.

Çështja e presidentit është kthyer në temën kryesore të diskutimit në skenën politike të Kosovës, pasi ka muaj që nuk arrihet një marrëveshje.

Lëvizja Vetëvendosje i ka fituar bindshëm zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit dhe gëzon 57 ulëse në Kuvend, por ato janë të pamjaftueshme për zgjedhjen e presidentit, meqë për të finalizuar këtë proces nevojiten të paktën 80 vota në Kuvendin me 120 deputetë.

## Rama thotë se do të rikthehet teleferiku i Gërmisë

PRISHTINË, 7 PRILL - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se shumë shpejt do të rikthehet teliferiku në zonën e Gërmisë. "Rikthimi i ski-liftit nuk është thjesht një projekt, është rikthim i një ndjenje që shumëkush e mban mend, dhe një mundësi e re për brezat që vijnë. Gërmia ka qenë

gjithmonë më shumë se një park, është hapësira jonë e përbashkët, frymëmarrja e qytetit dhe një potencial i pashfrytëzuar për t'u kthyer në një pistë të vërtetë skijimi dhe një pistë për sporte të tjera reaktive. Në një takim të zgjeruar me përfaqësues të komunitetit sportiv, organizatave rekreative dhe

institucioneve relevante, janë diskutuar në detaje hapat konkretë për realizimin e këtij projekti, i cili tashmë po merr trajtë të qartë zhvillimore", ka thënë Rama, duke shtuar se duke qenë se Gërmia është zonë e mbrojtur, çdo hap do të ndërmerret me kujdes maksimal, në përputhje të plotë me standardet më të larta

mjedisore dhe kornizën ligjore në fuqi. "Në koordinim të ngushtë me institucionet qendrore, po punohet intensivisht për qartësimin e procedurave dhe krijimin e bazës së nevojshme ligjore dhe teknike për jetësimin e këtij projekti. Një zhvillim i madh është në horizont", ka shkruar Rama në "Facebook".



## NJË MUAJ PARABURGIM NDAJ ISH-PJESËTARIT TË MPB-SË SERBE, I DYSHUAR PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË

PRISHTINË, 7 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji për një ish-pjesëtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, i arrestuar nën dyshime për krime lufte në Kaçanik.

A. D. u arrestua më 4 prill dhe, sipas Prokurorisë Speciale të Kosovës, ai ishte pjesëtar i MPB-së serbe në Ferizaj dhe polic i trafikut në rajonin e Kaçanikut në kohën kur dyshohet se ka kryer krime në mars të vitit 1999 në fshatin Ivajë dhe fshatrat përreth të Kaçanikut. Sipas Prokurorisë, ai dyshohet se "në bashkëkryerje me persona të tjerë ende të pidentifikuar të forcave policore, ushtarake serbe, më 09.03.1999, gjatë një aksioni të organizuar policor ushtarak kundër popullsisë civile shqiptare, i detyroi banorët të largohen nga

shtëpitë e tyre, të cilat më pas u dogjën dhe u shkatërruan".

Prokuroria, po ashtu, ka thënë se ai dyshohet për rrahjen dhe torturimin "në mënyrë brutale, çnjerëzore, fizike dhe psikike" dhe shkaktimin e "lëndimeve të rënda trupore" të 13 civilëve gjatë marrjes në pyetje në stacionin policor në Kaçanik.

Këta civilë ishin në mesin e 91 meshkujve që forcat serbe i kishin ndarë prej rreth 400 burrave, grave, pleqve e fëmijëve të grumbulluar për t'u dërguar në stacionin policor në Kaçanik, sipas Prokurorisë Speciale të Kosovës.

Arrestimi i A. D. nxiti reagime nga Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe, që tha se ai ishte një polic në pension nga një fshat i Prizrenit, duke e cilësuar arrestimin e tij të motivuar



"politikisht".

Arrestimi i fundit vjen pak javë pasi Gjykata në Prishtinë shqiptoi dënim me burgim ndaj dy ish-pjesëtarëve të forcave policore dhe ushtarake të Serbisë për krime lufte në Kosovë gjatë luftës së viteve 1998-99.

Gjykata në Prishtinë i dënoi më 18 mars Zoran Kostiqit me 15 vjet burgim, ndërsa Dragan Milloviqin me 7 vjet burgim.

Së voni autoritetet e Kosovës kanë arrestuar të dyshuar të shumtë dhe kanë ngritur një sërë aktakuzash për krime lufte në

Kosovë.

Ndërkaq, që nga përfundimi i luftës, dhjetëra të dyshuar janë dënuar për këto krime para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Fillimisht pas luftës, përkatësisht nga viti 2000 dhe 2008, krimet e luftës në Kosovë u hetuan nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008, nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX).

Më 2018, EULEX-i ia dorëzoi lëndët organeve vendore të drejtësisë.

Gjatë luftës në Kosovë janë vrarë më shumë se 13 000 civilë - shumica shqiptarë, ndërsa mijëra të tjerë janë zhdukur. Më shumë se 1 500 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur - pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

## AKB: BIZNESET PO MBIJETOJNË NËN BARRË TË RËNDË FINANCIARE, DEKLARATAT E ABDIXHIKUT JANË TË PAVËRTETA

PRISHTINË, 7 PRILL - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka hedhur poshtë deklaratat e kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhiku, se nga kriza e naftës po përfitojnë vetëm bizneset falë qeverisë.

Sipas AKB-së, kjo nuk qëndron. "Marzha prej vetëm 2 cent në shumicë dhe 12 cent në pakicë nuk përbën 'fitim të garantuar', por një hapësirë minimale mbijetese në një treg me kosto në rritje të vazhdueshme. Sot bizneset përballen me dyfishim të kapitalit qarkullues për furnizim me derivate të naftës, rritje të kostove financiare, përfshirë interesa bankare shumë më të larta se në vendet e BE-së Shtim të bazës tatimore dhe TVSH-së, që rrit barrën direkte mbi biznesin me rritje të provizioneve bankare dhe të rrezikut tregtar për turbulencë që po ndodhin në



tregjet globale", thuhet në reagimin e AKB-së.

AKB-ja thekson se bizneset nuk janë përfitues të krizës, por bartësit kryesorë të saj, duke mbajtur furnizimin e tregut dhe stabilitetin ekonomik në kushte jashtëzakonisht të vështira. "Deklaratat e tilla janë të

pabazuara dhe dëmtojnë klimën ekonomike dhe biznesin vendorë. Në vend të fajësimeve, kërkohen politika konkrete që mbështesin sektorin privat dhe mbrojnë qytetarëve dhe bizneset nga rritja e çmimeve dhe inflacionit që Kosova po importon", është thënë në reagimin e AKB-së.

## AFËR BANJSKËS POLICIA NDALON NJË AUTOMJET ME MALLRA TË KONTRABANDUARA

Mitrovicë, 7 prill - Më 6 prill rreth orës 19:15 në zonën e fshatit Banjškë dhe Sharani-Kamen në rrugë malore, njësitë policore dhe njësitë e Doganës së Kosovës gjatë një aksioni të përbashkët për luftimin e kontrabandës kanë vërejtur një automjet pa targa i cili lëvizte me shpejtësi të madhe. Njësitë policore janë vënë në ndjekje dhe pas pak kanë hasur në veturën e dyshimtë, por personi/at e kishin braktisur veturën dhe ishin larguar në drejtim të panjohur.

Gjatë kontrollit është vërtetuar se në veturë kishte mall të kontrabanduar 32 (tridhjetë e dy) thasë ma pantallona (1 217 palë xhinse) dhe 1 (një) thes me rripa të pantallonave (303 copë rripa). Gjithashtu në veturë janë gjetur edhe një palë targa të shtetit të



Serbisë, një kanistër i plastikës me naftë dhe një radiolidhje.

Njësitë nga Dogana e Kosovës kanë bërë konfiskimin e mallit të kontrabanduar.

Me udhëzimet e prokurorit të shtetit rasti mbetet të trajtohet nga Dogana e Kosovës.

## Azemi: Punëtorët teknikë dhe fizikë të Prishtinës kërkojnë pagë prej 600 eurosh

Prishtinë, 7 prill - Sindikata e Sektorit Privat e Kosovës ka organizuar takim me kryetarët e shoqatave sindikale. Në këtë takim u

diskutua për rritjen e pagave, pagën e 13 si dhe organizimin e protestës për 1 maj. Me këtë rast, kryetari Jusuf Azemi u është drejtuar medieve pas

takimit.

Azemi ka dhënë hollësi rreth vendimeve që janë ndërmarrë aty. "Është marrë vendim, nëse nga 1 korrik punëtorët

teknikë të Prishtinës nuk e kanë kontratën me pagën 600 euro, do ta lëshojnë vendin e punës në mënyrë kolektive", ka treguar ai.



# MBAHET PUNËTORIA PËR PLANIN STRATEGJIK 2026-2030: DREJT NJË UNIVERSITETI BASHKËKOHOR

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 PRILL - Universiteti i Prishtinës, si institucioni më i lartë publik i arsimit të lartë në vend dhe bartës i zhvillimit akademik, shkencor dhe shoqëror, organizoi punëtorinë e dedikuar për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të hartimit të planit strategjik 2026-2030. Kjo punëtori përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të një vizioni të përbashkët institucional, që synon avancimin e cilësisë, rritjen e konkurrueshmërisë dhe integrimin e plotë të Universitetit të Prishtinës në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe kërkimit.

Punëtorja u mbajt më 3 prill 2026, në ambientet e Modelariumit në Fakultetin e Arkitekturës, duke mbledhur përfaqësues të menaxhmentit qendror, dekanë, udhëheqës të divizioneve dhe drejtorive në kuadër të administratës qendrore, studentë dhe partnerë institucionalë, me qëllim konkretizimin e aktiviteteve dhe përcaktimin e indikatorëve të performancës në përputhje me objektivat strategjike.

Ky proces është zhvilluar mbi parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe vendimmarrjes së bazuar në evidencë, duke reflektuar angazhimin institucional për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt rezultateve.

Sesioni i parë i punëtorisë u hap me fjalët përshëndetëse të përfaqësuesve të nivelit më të lartë institucional dhe partnerëve strategjikë, të cilët theksuan rëndësinë e Planit Strategjik 2026-2030 si një dokument orientues për zhvillimin afatgjatë të Universitetit të Prishtinës.

Prof. Arben Hajrullahu, rektor i Universitetit të Prishtinës, në fjalën e tij përshëndetëse, ndër të tjera, theksoi se: "Plani Strategjik



2026 - 2030 përfaqëson një moment kyç në zhvillimin e Universitetit të Prishtinës. Ky dokument nuk është vetëm një kornizë planifikimi, por një deklaratë e qartë e ambicies sonë për të ndërtuar një universitet bashkëkohor, të integruar në hapësirën evropiane të arsimit dhe kërkimit, ku cilësia, inovacioni dhe ndikimi shoqëror janë në thelb të çdo veprimi".

Aqim Emurli, udhëheqës i projektit SHER, i cili është duke mbështetur universitetin në këtë proces të planifikimit zhvillimor, u shpreh: "Programi 'Sustainable Higher Education and Research in Kosovo' (SHER) synon të kontribuojë në një sektor të qëndrueshëm, të bazuar në evidencë, të orientuar nga nevojat dhe të ndjeshëm ndaj barazisë gjinore në fushën e arsimit të lartë

dhe kërkimit në Kosovë, i cili është plotësisht i harmonizuar me parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, Hapësirës Evropiane të Kërkimit dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Plani Strategjik i Universitetit të Prishtinës përfaqëson një hap konkret në operacionalizimin e këtyre parimeve përmes transformimit institucional".

Prof. Mimoza Ibrani, udhëheqëse e grupit punues dhe anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, vlerësoi procesin duke theksuar se: "Puna e përbashkët ishte një shembull i shkëlqyer i bashkëpunimit institucional, ku secili kontribuoi me ekspertizën dhe përvojën e tij për të ndërtuar një plan strategjik gjithëpërfshirës, të bazuar në analiza dhe nevoja reale të

zhvillimit universitar".

Prof. asoc. Majlinda Gjellaj, prorektore për zhvillim institucional, cilësi dhe çështje studentore, e cila udhëhoqi këtë punëtori, deklaroi se: "Përmes këtij plani, synojmë të vendosim një kulturë të qëndrueshme të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm, duke e vendosur studentin dhe performancën institucionale në qendër të çdo vendimmarrjeje".

Gjatë sesioneve punuese, pjesëmarrësit e angazhuar në mënyrë aktive kontribuan me reflektime dhe vlerësime të rëndësishme mbi përmbajtjen dhe drejtimin e Planit Strategjik 2026-2030.

Diskutimet u karakterizuan nga një qasje konstruktive dhe bashkëpunuese, ku u theksua rëndësia e forcimit të kulturës

institucionale të cilësisë, zhvillimit të dialogut ndërmjet njësive akademike dhe menaxhmentit, si dhe përfshirjes reale të studentëve në proceset vendimmarrëse.

Punëtorja nxori në pah rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet njësive akademike dhe menaxhmentit qendror për zhvillimin e ideve inovative dhe të zbatueshme, duke theksuar gjithashtu rolin thelbësor të përfshirjes së studentëve në proceset vendimmarrëse si një hap drejt një universiteti më demokratik dhe gjithëpërfshirës.

Plani përqendrohet në rritjen e cilësisë akademike, përmirësimin e përvojës studentore, zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit, zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare, fuqizimin e qeverisjes institucionale dhe avancimin e transformimit digjital.



## Gjykata Kushtetuese hap dyert për qytetarët

PRISHTINË, 7 PRILL - Gjykata Kushtetuese do ta organizojë aktivitetin e radhës "Dita e Gjykatës së Hapur" të mërkurën, më 8 prill, në shënim të Ditës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratuar më 9 prill të vitit 2008. Në këtë ditë, të gjithë qytetarët, veçanërisht studentët e drejtësisë, përfaqësuesit e komunitetit juridik dhe vizitorët e tjerë, do të kenë mundësi ta vizitojnë objektin e Gjykatës Kushtetuese dhe të njihen më për së afërmi me Gjykatoren, me Bibliotekën dhe me

ambientet në të cilat punojnë gjyqtarët dhe zyrtarët e Gjykatës, si dhe të informohen drejtpërsëdrejti përkitazi me historikun, me punën e deritanishme dhe me kompetencat kushtetuese të këtij institucioni.

Organizimi i vizitës së qytetarëve të interesuar do të bëhet në përputhje me kapacitetet akomoduese që ofron ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese dhe për grupe prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) personash në të njëjtën

kohë.

Vizitat do të organizohen çdo orë, ndërmjet orës 10:00 dhe 14:00, ndërsa kohëzgjatja maksimale e vizitës do të jetë dyzet e pesë (45) minuta.

Para vizitës në Gjykatë, të gjithë vizitorët e moshës mbi 16 vjeç duhet të kenë me vete dhe të dorëzojnë në reception një dokument zyrtar identiteti (kartë studentore, letërnjoftim apo pasaportë). Gjatë vizitës vizitorët do të kenë mundësi të bëjnë foto vetëm në Gjykatore dhe në oborrin e Gjykatës.

## Vlerësohet partneriteti mes Ministrisë së Bujqësisë dhe UNDP-së

PRISHTINË, 7 PRILL - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja, ka pritur në takim shefin e Zyrës së UNDP në Kosovë, Nuno Queiros. Me këtë rast, Queiros e uroi ministrin Muja për marrjen e detyrës së re, duke i dëshiruar suksese në ushtrimin e përgjegjësiave dhe në avancimin e

sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural në vend. Nga ana e tij, ministri Muja falënderoi për vizitën dhe urimin, duke theksuar gatishmërinë e tij për ta thelluar bashkëpunimin ndërinstitucional me UNDP-në. Ai u shpreh i hapur për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta që synojnë

zhvillimin e qëndrueshëm, përmirësimin e kushteve në zonat rurale dhe fuqizimin e sektorit bujqësor. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan rëndësinë e partneritetit të vazhdueshëm dhe u pajtuan për shtimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët.



## PËRBALLË SHTRENJTIMIT TË NAFTËS, A JANË VETURAT ELEKTRIKE OPSION PËR QYTETARËT?

PRISHTINË, 7 PRILL - Së fundi çmimet e naftës në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme, duke arritur deri në rreth 1.8 euro për litër.

Me një konsum mesatar prej 6 deri në 7 litra për 100 kilometra, një veturë me naftë mund të shpenzojë rreth 10 deri në 12 euro karburante për ta kaluar këtë distancë.

Por, a mund të jetë një veturë elektrike zgjidhja për qytetarët e shqetësuar nga rritja e çmimeve të karburanteve?

Përgjigjja është e thjeshtë për Fidan Hallaqin, pronar i kompanive E-Charge dhe E-Taxi, dhe Zeqir Smajlin, pronar i kompanisë DGI Kosova. "Sot mund t'ua rekomandojmë qytetarëve në Kosovë të blejnë veturë elektrike, veçanërisht nëse jetojnë ose punojnë në qytetet kryesore dhe kanë qasje në mbushje të rregullt", thotë Hallaqi për REL-in. "Infrastruktura aktuale nuk është perfekte, por është e mjaftueshme për përdorim praktik të përditshëm", shton ai.

E, si ndikon rritja e çmimit të energjisë elektrike në vitet e fundit në Kosovë? Smajli shpjegon se kostoja e përdorimit të veturave elektrike mbetet dukshëm më e ulët sesa ajo e derivateve.

Veturat elektrike konsumojnë mesatarisht 15 deri në 20 kWh për 100 kilometra. Kjo përkthehet në kosto dukshëm më të ulët: më pak se 1 euro për 100 kilometra nëse mbushja bëhet në shtëpi gjatë tarifës së ulët, ose deri në 3 apo 4 euro në pika publike.

E-Taxi është një kompani e taksive që operon vetëm me vetura elektrike, ndërsa E-Charge është rrjeti i parë publik i mbushjes për vetura elektrike në Kosovë. Kurse, kompania e Smajlit, që ka dy vjet që funksionon në treg, bën importimin e këtyre veturave në Kosovë.

Smajli thotë se, në Kosovë, interesimi për vetura elektrike është rritur gradualisht, fillimisht nga bizneset me shpenzime të mëdha për karburante, e më pas



edhe nga qytetarët. "Sidomos në këto periudha të shtrenjtimit të derivateve është rritur edhe më shumë interesimi dhe shitja", thotë ai.

Shumica e veturave elektrike që janë importuar në vitet e fundit në Kosovë, janë të reja.

Kjo për shkak se, ndryshe nga veturat e reja, ato të përdorura ngarkohen me akcizë shtesë në bazë të vjetërsisë - çka rrit çmimin përfundimtar dhe i bën më pak tërheqëse për importuesit.

Megjithatë, sipas Smajlit, edhe çmimi i blerjes së veturave të reja mbetet pengesë. Nëse në Kosovë, një veturë elektrike mund të kushtojë rreth 24 deri në 25 mijë euro, në disa vende të tjera të Evropës, si Shqipëria, e njëjta mund të blihet për 19 deri në 20 mijë euro, thotë ai, për shkak të lehtësirave fiskale. "Dogana dhe TVSh-ja te ne arrijnë diku rreth 28 për qind... dhe qytetarët detyrohen t'i paguajnë ato", thotë Smajli.

Edhe pse në të kaluarën është diskutuar për heqjen e taksës së regjistrimit për veturat elektrike, aktualisht nuk ka lehtësira konkrete as për import, as për regjistrim. Këtë e konfirmon për REL-in pronari i një kompanie që merret me regjistrimin e veturave. Ndërsa, pyetjet drejtuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor lidhur me strategjinë, subvencionet dhe planet për zhvillimin e infrastrukturës për veturat elektrike, kanë mbetur pa përgjigje.

Shumë vende të tjera po stimulojnë qytetarët drejt veturave elektrike për shkak të lidhjes edhe me përfitimet mjedisore. Veturat elektrike nuk prodhojnë emetime direkte gjatë përdorimit, çka mund të kontribuojë në uljen e ndotjes së ajrit, që në disa qytete të Kosovës tejkalon kufijtë e lejuar, sidomos gjatë dimrit.

Megjithatë, në Kosovë, ku prodhimi i energjisë mbështetet kryesisht në qymyr, efekti i veturave elektrike në reduktimin e ndotjes mbetet i kufizuar.

Të dy bashkëbiseduesit, Hallaqi dhe Smajli, përmendin mungesën e mbështetjes institucionale si një ndër problemet kryesore.

Hallaqi thotë se politikat aktuale nuk janë në favor të veturave elektrike. "Tranzicioni drejt elektromobilitetit kërkon qasje afatgjatë, stabilitet rregullator dhe koordinim të fortë ndërmjet sektorit publik dhe privat. Pa këtë, zhvillimi do të ndodhë, por me ritëm më të ngadaltë se potenciali real i tregut", thotë Hallaqi.

Ai e përmend Shqipërinë si rrëfim suksesi sa iu përket politikave favorizuese ndaj veturave

elektrike, përdorimi i të cilave ka tejkaluar mesataren e BE-së.

E pikërisht në këtë pikë, thotë ai, Kosova ka pasur ngecje.

Ai shpjegon se veturat me motor me djegie të brendshme nga Bashkimi Evropian mund të përfitojnë lehtësira në import në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, e cila parasheh heqje graduale të tarifave doganore për produktet me origjinë nga BE-ja. Megjithatë, veturat elektrike shpesh nuk i gëzojnë këto lehtësira për shkak të rregullave të origjinës, pasi komponentët e tyre prodhohen jashtë BE-së, duke i bërë ato subjekt të tarifës doganore prej rreth 10 për qind.

Në disa raste edhe për veturat hibride aplikohen norma më të favorshme të akcizës si masë për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa veturat plotësisht elektrike nuk trajtohen në të njëjtën mënyrë në kuadër të legjislacionit aktual për akcizën.

Smajli thotë se kjo lidhet me faktin se korniza ligjore dhe udhëzimet administrative përkatëse janë hartuar para se veturat elektrike të ishin të pranishme në tregun vendor, duke lënë boshllëqe në trajtimin e tyre.

Strategjia e Energjisë 2022-2031 parasheh që numri i veturave elektrike në Kosovë të arrijë në

rreth 15 mijë deri në vitin 2031.

Por, edhe në këtë skenar, ato do të përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të flotës së përgjithshme të automjeteve prej mbi 400 mijë veturash që qarkullojnë në vend deri në vitin 2024.

Një tjetër shqetësim i konsumatorëve për përdorim praktik të veturave elektrike mbetet i lidhur ngushtë me infrastrukturën.

Hallaqi thotë se, në Kosovë, edhe zhvillimi i këtij sektori po ecën më ngadalë krahasuar me vendet e rajonit. Ai tregon se ende ka zona ku mungon qasja në pika të mbushjes, sidomos jashtë qendrave urbane dhe në disa korridore rrugore. Megjithatë, sipas tij, rreziku për të mbetur pa bateri është i ulët. "Me disiplinë operative dhe planifikim të duhur, rreziku që një veturë të mbetet pa energji gjatë punës është minimal", thotë ai.

Kompania e tij operon 32 pika të mbushjes në rajonin e Prishtinës, në aksin Prishtinë-Tiranë dhe në Shqipëri. "Qasja jonë ka qenë të ndërtojme një rrjet praktik dhe të përdorshëm për përdoruesit e përditshëm, duke siguruar që mbushja të jetë e disponueshme aty ku ka kërkesë reale", thotë ai.

Në anën tjetër, Smajli thekson se autonomia e veturave elektrike - pra distanca që mund të përshkojnë pa pasur nevojë për rimbushje - është e mjaftueshme për distancat në Kosovë dhe se infrastruktura nuk duhet të jetë pengesë për qytetarët. "Për qytetarët e thjeshtë, [vetura elektrike] është zgjedhje jashtëzakonisht e mirë, sepse ka autonomi të mjaftueshme. Minimumi është rreth 400 km autonomi. Nëse i llogarisim qytetet e Kosovës, qyteti më i largët prej Prishtinës është rreth 100 kilometra", thotë Smajli për REL-in.

Ngjashëm vlerëson edhe Hallaqi. "Në terma praktikë, vendimi për të kaluar në veturë elektrike sot është më shumë çështje zgjedhjeje dhe planifikimi, sesa kufizim teknik", përfundon ai.

## Nafta të martën në Kosovë 1.88 euro për litër, benzina 1.46 euro

PRISHTINË, 7 PRILL - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) ka njoftuar se bazuar në vendimin e datës 05.04.2026 për caktimin e çmimit maksimal për datën


07.04.2026, çmimet maksimale të lejuara janë: Çmimi maksimal i lejuar i produktit dizel është: 1.88 euro për litër; Çmimi maksimal i lejuar i produktit Benzinë është: 1.46 euro për litër; Çmimi maksimal

i lejuar i produktit gaz është: 0.74 euro për litër.

MINTI u bënë thirrje të gjithë operatorëve ekonomikë që të zbatojnë me përpikëri vendimin e ri të marrë nga ministrja Kusari-Lila, me

qëllim garantimin e një tregu funksional, të qëndrueshëm dhe në shërbim të interesit të konsumatorit.

Shkeljet e këtij vendimi do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.



KUSHTUAR HEROIT TË KOMBIT – BESIM NDRECA

# SE LIRI DONTE KOSOVA

FADIL HYSENAJ (KABASH)  
PUKË – SHQIPËRI

Moj Kosovë plot histori  
Ke lind trima me shumë lavdi  
Me lot n'sy po e nisi shkrimin  
T'shkruaj vargje për trim Besimin  
N'Maqitev t'Suharekës  
Rritet Besa i' pushkës e'besës  
E kreu shkollën n'Fshat t'Mushtishit  
Si n'koh t'masakrës Rankoviçit  
N'çdo përpjekje që Besa ra  
Kacafytej me Serbin Shkja  
Donte shpirtin me jau marr  
Zemra tij kish gjak shqiptar  
N'demonstrata, printe i pari  
Tmerr e kishte Serbomadhi  
N'burg e fusin Besim trimin  
Por shqiptari kish ba betimin  
Për Kosovë kurr mos meu ndal  
Jetën time ja kam fal  
Kurr Besimit si dridhej dora  
Se liri donte Kosova  
Shkojn te puna me arrestu  
Gjall Besimi s'ka pranu  
Meu dorzu gjall nuk pranon  
Komondantin drejt e qëllon  
Ja mur shpirtin ja mur jetën  
Si shqiptar e tregoi veten  
Por Besimit i' shkojn te shpia  
Me bastis don policia  
I maskuar arrin t'largohet  
N'mes Greikocit e Korishit ai rrethohet  
Vritet trimi i Dardanis  
Heroi Kosovës gjith Dardanis  
Kshtu dha jetën Besim Ndreca  
Përrjetsisht s't'harrohet  
vepra !!



## HEROI I KOMBIT - BESIM NDRECA



# PAKICA QË 'BËRTET'. PSE RRJETET SOCIALE KRIJOJNË ILUZIONIN E SHUMICËS



Në rrjetet sociale, ai që duket si mendimi i shumicës shpesh nuk është aspak shumicë. Është thjesht zëri më i lartë, më i shpeshtë dhe më agresiv. Një grup i vogël përdoruesish, shumë aktivë dhe shpesh më ekstremë në qëndrime, arrijnë të krijojnë përshtypjen se përfaqësojnë të gjithë. Kështu lind një nga shtrembërimet më të rrezikshme të epokës digjitale: iluzioni i shumicës. Dhe kur njerëzit nisin të heshtin, vetëm sepse mendojnë se janë në pakicë, ky iluzion bëhet edhe më i fortë.

## Çfarë është iluzioni i shumicës?

Rrjetet sociale amplifikojnë zërin e atyre që flasin më shumë, por kjo nuk do të thotë se ata përfaqësojnë shumicën. Kjo sjell një fenomen të quajtur iluzion kolektiv – një situatë ku shumica e njerëzve shkojnë pas një ideje që në fakt nuk e mbështesin, vetëm sepse mendojnë se shumica tjetër e grupit e mbështet. Si pasojë, grupi

vepron në mënyra që pak njerëz në të vërtetë i pëlqejnë. Ky iluzion ndikon në mënyrën se si e konceptojmë jetën, marrëdhëniet, dhe institucionet. Rrjetet sociale veprojnë si një dhomë pasqyrash që shtrembëron realitetin. Problemi nuk është vetëm se disa flasin më shumë. Problemi është se algoritmet i shpërblejnë pikërisht ata. Përmbajtja më emocionale, më polarizuese dhe më provokuese ka më shumë gjasa të komentohet, të shpërndahet dhe të marrë reagime. Kjo krijon një cikël ku ekstremi bëhet më i dukshëm se normalja, ndërsa zërat më të ekuilibruar zhduken në sfond.

## Pse rrjetet sociale e shtrembërojnë realitetin

80% e përmbajtjes në rrjetet sociale krijohet nga vetëm 10% e përdoruesve – një grup që shpesh ka qëndrime ekstreme, në lidhje me shumicën e çështjeve sociale. Ky grup krijon iluzionin e një shumice që mendon, duke heshtur shumë të

tjerë. Kjo është arsyeja pse shumica prej nesh ose e detyrojmë veten të heshtim, ose pranojmë me kokëulje, duke e bërë këtë iluzion një profeci të vetë-përmbushur.

Kjo ka pasoja të drejtpërdrejta në jetën reale. Njerëzit fillojnë të besojnë se mendimi i tyre është “jashtë kohe”, “i papranueshëm” ose “në pakicë”, edhe kur në fakt nuk është. Për të shmangur sulmin, talljen apo izolimin, shumë zgjedhin të heshtin. Kështu krijohet një spirale heshtjeje: sa më shumë hesht shumica, aq më e fortë duket pakica që dominon ekranin.

## Si një pakicë shumë aktive dominon debatin online

Nuk është çudi që liderët që kërkojnë të ruajnë pushtetin janë të parët që përdorin këto mjete për të manipuluar mendimin publik. Një shembull është Nicolas Maduro, lideri i Venezuelës. Për një kohë të gjatë, në rrjetet sociale dukej sikur ai kishte mbështetje të gjerë. Çdo


deklaratë e tij pozitive ripostohej dhe shpërndahej gjerësisht. Por, shumë nga këto “ndjekës” dolën të jenë të ashtuquajturat bots – llogari false që ekzistonin vetëm për të përfoluar mesazhet e tij dhe për të sulmuar opozitën. Në këtë mënyrë, rrjetet sociale nuk pasqyrojnë thjesht realitetin: ato shpesh e deformojnë atë. Ajo që shohim online nuk është domosdoshmërisht ajo që mendojnë njerëzit në të vërtetë, por ajo që platforma vendos të amplifikojë. Prandaj, për të kuptuar më mirë shoqërinë, nuk mjafton të shohësh trendet apo komentet më të zhurmshme; duhet të dëgjosh edhe ata që nuk bërtasin.

## Si të mos biesh pre e iluzioneve kolektive

Rrjetet sociale janë një arenë ku kushdo mund të bërtasë më fort ose të heshtë të tjerët duke u maskuar si shumicë. Nëse heshtim dhe nuk sfidojmë atë që mendojmë se beson grupi, ndihmojmë që ai grup të shkojë në drejtimin e gabuar.

Për të shmangur ndikimin e iluzioneve kolektive, duhet të gjejmë kohë për të dalë jashtë hapësirës virtuale dhe për të ndërtuar lidhje reale. Bisedat me familjen, fqinjët dhe komunitetin janë çelësi për të ruajtur një perspektivë të shëndetshme. Nuk duhet lejuar që shtrembërimi i rrjeteve sociale të ndikojë në mënyrën se si i trajtojmë njerëzit në jetën reale. Ndërkohë që rrjetet sociale nuk do të zhduken, fuqia e tyre për të krijuar iluzione mund të kufizohet kur secili nesh vendos të flasë dhe të qëndrojë i vërtetë ndaj mendimeve dhe vlerave të veta.

Shumica e vërtetë nuk është gjithmonë ajo që duket në ekran. Shpesh, ajo është e heshtur, e lodhur, e paineresuar për konfliktin e përhershëm online. Por heshtja e saj i jep më shumë fuqi pakicës që bërtet. Dhe pikërisht këtu qëndron rreziku më i madh i rrjeteve sociale: jo vetëm se na tregojnë një realitet të shtrembëruar, por se na bindin ta pranojmë atë si të vërtetë. / bota.al



## Robert Rrahmani zgjidhet "Ylli i Javës" në Superligë

PRISHTINË, 7 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës - "Albi Mall", ka vazhduar ndarjen e çmimit tradicional "Ylli i Javës", i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit vendor. Për javën e 27 të këtij edicioni,

ky çmim i është dhënë futbollistit të SC Gjilani, Robert Rrahmani, i cili ka shënuar golin e parë për skuadrën e tij në fitoren e rëndësishme si mysafir kundër Prishtinës së Re, me rezultat 2-1. Me këtë fitore skuadra e drejtuar nga Debatik Curri ka bërë një hap të madh drejt objektivit për ta

siguruar njërin nga pozitat që dërgon në Evropë. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, tekta pasi ka marrë këtë çmim, Rrahmani ka shprehur lumturi që është shpallur lojtari më i mirë i javës. "Trajneri dhe stafi e kanë përgatitur ndeshjen në

maksimum, duke mos e nënvlerësuar Prishtinën e Re për shkak të tabelës. Lojtarët i kanë zbatuar këshillat e trajnerit në maksimum. Fitorja ka qenë shumë e vlefshme, pasi synimi i klubit është arritja e objektivave dhe dalja në Evropë, dhe me këtë fitore jemi brenda objektivave. Këtë çmim



ua dedikoj bashkëlojtarëve, stafit dhe familjes sime, pasi edhe ata kanë merita që unë sot e fitoj çmimin 'Lojtari i Javës', ka thënë Rrahmani për faqen zyrtare të FFK-së.

## KOMISIONI PARLAMENTAR MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR LOJËRAT MESDHETARE "PRISHTINA 2030"

PRISHTINË, 7 PRILL - Komisioni për Kulturë, Turizëm dhe Sport ka miratuar Projektligjin nr. 10/L-027 për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030". Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Blerim Gashani, gjatë raportimit në këtë komision, ka thënë se qëllimi i projektligjit është përcaktimi i rregullave, procedurave, detyrave dhe përgjegjësi të institucioneve për organizimin e kësaj ngjarjeje sportive. Në këtë kontekst, Gashani ka thënë se qeveria do të ndajë fonde publike për këtë qëllim në shumën prej të paktën 253 milionë e 445 mijë e 501 eurosh. "Ky projektligj rregullon



gjithashtu kompetencat e Komitetit Olimpik të Kosovës, të komunës së Prishtinës, si dhe të komunave të tjera, të cilat do t'i përmbushin obligimet e tyre në raport me organizimin e Lojërave Mesdhetare 'Prishtina 2030'. Në përputhje me mbështetjen financiare të garantuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në dokumentin e kandidaturës, burimi kryesor i financimit për organizimin e Lojërave Mesdhetare do të jetë buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës, përkatësisht Ministria e Sportit dhe Rinisë, e ka sportin prioritet. Duke pasur parasysh se Kosova

tashmë ka marrë përsipër organizimin e këtyre lojërave që do të mbahen në vitin 2030, është e domosdoshme adresimi i një sërë kërkesash obliguese, ndër të cilat është krijimi i kushteve sa më të mira për zhvillimin e ngjarjes sportive në vend. Gjithashtu, konsiderojmë se përmes këtij projektligji do të krijohen mekanizma adekuatë për organizimin e ngjarjes sportive, duke paraparë bashkëpunimin institucional dhe duke siguruar që të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për realizimin sa më të suksesshëm të tyre", ka thënë Gashani.

## "THE GUARDIAN": MURIQI NGA DHIMBJA ME KOSOVËN TE HERO I MALLORCAS NDAJ REAL MADRIDIT

MALLORCA, 7 PRILL - Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, ka marrë vëmendje të madhe nga mediumi prestigjioz "The Guardian" pas paraqitjes së tij vendimtare me RCD Mallorca kundër Real Madridit. "The Guardian" i ka kushtuar një shkrim të veçantë Muriqit, duke e përshkruar rikthimin e tij si një histori të fortë emocionale. "Vedat Muriqi la pas zhgënjimin nga humbja e Kosovës në 'play-off' -in e Kupës së Botës për të shënuar një gol dramatik në fund, duke tronditur Real Madridin dhe

duke kompletuar një kthesë emocionale brenda pak ditësh", ka shkruar "The Guardian". Sipas "The Guardian", goli i tij në minutat shtesë ishte vendimtar jo vetëm për ndeshjen, por edhe për garën për titull në La Liga. "Goli i tij në kohën shtesë jo vetëm që i siguroi Mallorcas një fitore jetike, por gjithashtu i dha një goditje të rëndësishme të Real Madridit për titull, duke nënvizuar rëndësinë e tij për ekipin", ka shkruar mediumi britanik. Ndërkohë sulmuesi i Kosovës



po kalon sezonin më të mirë në karrierë, duke qenë një nga golashënuesit më të dalluar në ligë dhe një faktor kyç për sukseset e Mallorcas, ku artikulli ka theksuar edhe për këtë pjesë duke theksuar rolin e madh që ka Muriqi te Mallorca, gjatë këtij sezoni. "Muriqi ka mbajtur një pjesë të madhe të barrës sulmuese të Mallorcas këtë sezon, duke shënuar një përqindje të jashtëzakonshme të golave të ekipit dhe duke u treguar i pazëvendësueshëm në luftën për mbijetesë", ka shkruar "The Guardian".

Më tutje, "The Guardian" ka shkruar për momentin më emocional të Muriqit, i cili ka ardhur pas ndeshjes, kur sulmuesi i Kosovës nuk i ka mbajtur emocionet. "I pushtuar nga emocionet pas fishkëllimës përfundimtare, Muriqi ka shpërthyer në lot, një reflektim i dhimbjes dhe presionit që kishte përjetuar në ditët e fundit", ka shkruar mediumi britanik. "Pirati" i Kosovës është shumë pranë thyerjes së rekordit historik të golave të klubit të Mallorcas, që mbahet nga Samuel Eto'o.

## 300 fitore në karrierë për Spalletin

TORINO, 7 PRILL - Trajneri i Juventusit, Luciano Spalletti, ka arritur një moment të madh në karrierën e tij, duke regjistruar fitoren e 300 si trajner. Tekniku italian është duke vazhduar ta dëshmojë përvojën dhe klasën e tij në pankinë, duke qenë një nga trajnerët më të respektuar në futbollin evropian, me një

karrierë të gjatë dhe të suksesshme. Para se ta merrte drejtimin e Juventusit në vitin 2025, Spalletti ka udhëhequr shumë skuadra të njohura. Ai e kishte nisur karrierën te Empoli, ndërsa më pas ka drejtuar klube si Sampdoria, Venezia, Udinese dhe Ancona. Më vonë, Spalletti

ka shkëlqyer me Romën në dy periudha të ndryshme, ndërsa ka pasur përvojë edhe jashtë Italisë me Zenit St. Petersburg, ku ka fituar tituj të rëndësishëm. Gjithashtu, ai ka qenë trajner i Interit dhe Napolit, me këtë të fundit që arriti kulmin duke fituar titullin kampion në Serinë A sezonin

2022/23. Pas kësaj, ai ka marrë drejtimin e kombëtares së Italisë, para se të rikthehej sërish në nivel klubesh me Juventusin. Fitorja e 300 është një tjetër dëshmi e karrierës së jashtëzakonshme të Spallettit, i cili vazhdon të shkruajë histori në futbollin italian dhe evropian.









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
®  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

